

ANILA OMARI

**NDIKIMET SLLAVE NË ‘MESHARIN’ E BUZUKUT:
KONTRIBUTI I CAMAJT**

Në studimet buzukjane janë vënë re me kohë ndikimet që ka pësuar shkrimtari i parë i shqipes dhe vepra e tij nga bota kulturore-fetare e fqinjëve veriorë sllavë të pjesës perëndimore të Ballkanit me dalje në detin Adriatik. Megjithatë vendi që zë komponenti sllav në veprën e Buzukut nuk është studiuar sa duhet në përmasat e peshën e vet. Ndër autorët që u kushtuan vëmendje të veçantë elementeve sllave të veprës së Buzukut një kontribut të rëndësishëm ka dhënë Martin Camaj.

Lidhjet e vjetra dalmatokroate-shqiptare që kanë në bazë njësinë kulturore latino-romane të “gjysmërrethit verior” të Adriatikut janë bërë të njohura tashmë nga albanologët e mëdhenj Šufflaj dhe Jireček. Që nga veriu i Lezhës, ku kalonte vija që ndante qarkun kulturor të Adriatikut në dy pjesë, ngriheshin një grup qytetesh në Shqipërinë e Veriut, që ishin nën ndikimin e Raguzës në mesjetë. Edhe në pikëpamje fetare, këto qytete, të cilësuar si “fidanishtja e krishterimit në Adriatikon lindor”¹, mbetën nën ndikimin kryesor të Perëndimit, në kontakt të vazhdueshëm me Romën latine. Me ndarjen e Perandorisë Romake në vitin 395, pas së cilës Dalmacia mbeti nën Perëndimin, kurse Prevali dhe Epiri nën Lindjen, rrethanat nuk ndryshuan: në të gjitha ato vende ku kishte bërthama të forta të popullsisë qytetare romake krishterimi ruajti karakter latin². Mbas shek. X, kur Durrësi, qytet metropolitor me përbërje të dyfishtë fetare, humbi peshkopatat e veta veriore, Tivarin dhe Ulqinin, erdhën duke fituar epërsi qytetet ipeshkvnore të Raguzës dhe Tivari mbi peshkopatat e vogla të Shqipërisë së Veriut që ndodheshin nën varësinë e Papës. Në shekujt pasues alternohej primati i Raguzës me atë të Tivari, deri sa, në shek. XIII, me themelimin e kishës autoqefale serbe, Tivari, për shkak të pozitës gjeografike fitoi nga kuria e Romës rëndësinë e rojes katolike në Ballkanin ortodoks. Nga ana e vet, kisha serbe erdhi duke u fuqizuar bashkë me pushtetin e mbretërve serbë dhe ndikoi për depërtimin e ortodoksizmit nga brendësia në drejtim të detit e të zonave latine, deri në kohën e pushtimit

¹ M. Shufflaj, *Serbët dhe shqiptarët*, Botimet Toena, Tiranë, 2004, f.107.

² M. Shufflaj, vep. cit., f. 108-109.

turk³. Kështu, krahinat e Shqipërisë së Veriut e të Zetës, sidomos zonat midis Ulqinit, Raguzës e Prizrenit, qenë zona ku bashkëjetonin popullsi shqiptare, sllave e vllahe dhe ku katolicizmi konkurronte me ortodoksinë herë në paqe e herë në konflikt, por jo me forma të ashpra⁴, deri sa rreziku turk ndikoi në forcimin e vetëdijes katolike të shqiptarëve kundrejt islamizimit. Krahina e Krajës, në përfundim të liqenit të Shkodrës, ishte një zonë tipike me popullsi të përzier, ku kulti i shenjtit Gjon Vladimiri, i festuar në Shqipëri e në Mal të Zi, por edhe më gjerë në Ballkan, bashkonte në shek. XV besimtarët katolikë e ortodoksë, kurse në kohët e sotme edhe ata myslimanë, të cilët kremtojnë bashkërisht ditën e Rrëshajave, që bie afër festës së Shën Vladimit. Duhet të kujtojmë se për këtë krahinë ose për krahinën e Shestanit fqinje me të, ka pasur studiues si Çabej, Camaj e Domi, që në bazë të veçorive dialektore të gjuhës së Buzukut, e kanë menduar si vendlindjen e Gjon Buzikut⁵.

Këto rrethana historike, gjeografike, antropologjike, kulturore e fetare janë sfondi i veprimtarisë letrare të Gjon Buzikut, në të cilin shpjegohen ndikimet sllave në veprën e tij. Duhet pohuar këtu gjithsesi me Çabejn se orientimi kryesor i Buzikut në përkthimin e veprës së tij ishte Italia latino-romane, me një komponente sllave jugore, drejtime të cilat shfaqen qoftë në mënyrën e përkthimit, qoftë në grafi⁶.

N. Jokli së pari në studimin e tij për Buzukun në 1930⁷, e pak kohë mbas tij Mario Roques-u, themeluesi i filologjisë së teksteve të vjetra shqipe⁸, vunë re huazimet e alfabetit të Buzikut nga alfabeti cirilik kroat, e ashtuquajtura *bosančica*, i përdorur nga katolikët kroatë në Dalmaci, në Raguzë e në Bosnjë në tekstet e tyre fetare në gjuhën popullore. Kjo ishte një dëshmi se Buzuku ishte në kontakt me grupet e sllavëve që përdornin këtë alfabet. Për tingujt e shqipes që nuk i kishte alfabeti latin, Buzuku përdori disa shenja të veçanta jolatine, të cilat u gjykuan nga studiuesit si përshtatje të grafemave sllave-cirilike për nevojat e shkrimit të shqipes.

³ Po ai, po aty, f. 115-122.

⁴ Po ai, f. 122.

⁵ E. Çabej, 'Meshari' i Gjon Buzikut (1555)", botim kritik, pjesa I, Tiranë, 1968, f. 21-22. M. Camaj, *Il "Messale" di Gjon Buzuku*, Roma, 1960, f. 49-51. M. Domi, "Libri i parë shqip", f. 3-8 (shih Dh. Shuteriqi, *Tekstet shqipe*, f. 109).

⁶ E. Çabej, 'Meshari', I, vep. cit. f. 50.

⁷ N. Jokl, "Nji studim per rreth librit të Buzikut", *Hylli i Dritës*, VI, nr. 3, Shtypshkroja françeskane, Shkodër, 1930.

⁸ M. Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paul Geuthner, Paris, 1932, f. 12 v.

Vlerat fonematike të këtyre shenjave u interpretuan në fillim nga Jokli, më pas nga Justin Rrota⁹ e nga Martin Camaj¹⁰, për t’u zbërthyer më me hollësi nga Çabej në botimin e tij kritik të ‘Mesharit’. Këto ishin: 1. grafema ⟨oy⟩ (*uk*-u cirilik) që te Buzuku u përdor, përveç se për [u], e [y], edhe me një vlerë të veçantë të [u]-së, të interpretuar nga Çabej si një [u9] pjesë e një diftongu [u9ë]¹¹; 2. grafema ⟨E⟩, që sipas M. Roques-it është një variant i *zemlja*-s cirilike i rumbullakosur dhe i kthyer djathtas që haset në dokumentet kroate të shek. XV, vlera fonetike e së cilës te Buzuku është kryesisht z [z]e zh [Z]. 3. Për M. Roques-un edhe shenja ⟨z⟩, te Buzuku me vlerën e x-së [dz], është më tepër një *zemlja* cirilike, megjithëse gjendet në tekstet e shtypura jo vetëm cirilike por edhe latine të kohës, me përhapje në Italinë e Veriut, gjë që e bën Çabejn ta vërë në dyshim burimin sllav. 4. Shenja ⟨3⟩, për spirantet ndërdhëmbore *th* [q] e *dh* [Δ], është një përshtatje e deformuar e grafemës cirilike ⟨ž⟩ *ksi*, siç pranohet nga studiuesit që nga Jokli¹². Roques-u jep indikacione për modele të mira të kësaj shenje në tekstin liturgjik sllavo-kishtar me shkronja cirilike *Triod Posni* të Stefan Marinović-it nga Shkodra, të shtypur në Venedik më 1561¹³. 5. Grafema ⟨ђ⟩ (*đerv*) që nuk gjendet në ciriliken e sllavishtes së vjetër kishtarë, është marrë nga varianti cirilik i Bosnjës, në të cilin shënon afrikatat prepalatale [ć] e [đ] të serbo-kroatishtes. Në tekstin e Buzukut kjo shenjë përdoret jo vetëm për grykoret palatale [q] e [gʲ], por edhe për mbylltoren [g], gjë për të cilën është diskutuar në një studim të fundit¹⁴. 6. Buzuku përdori edhe një shenjë tjetër sllave, të ashtuquajturin *vidi* (◌̋) të përdorur nga sllavët katolikë të Bosnjës e ndonjëherë edhe të Dalmacisë për të shënuar [v]-në. Te Buzuku kjo shenjë gjendet vetëm te fjala *uu* = *ū* “uri” dhe shënon tingullin [u]¹⁵. Çabej ka vënë re edhe gjurmë të tjera sllave në grafinë e Buzukut, siç janë kombinimi i shkronjave ⟨gE⟩,

⁹ J. Rrota, *Monumenti më i vjetri i giuhës shqype*. D. Gjon Buzuku (1555), Shkodër, 1930, Po ai, *Për historin e Alfabetit Shqyp*, Shkodër, 1936, f. 7-10.

¹⁰ M. Camaj, *Il “Messale”*, vep. cit., f. 12.

¹¹ E. Çabej, “*Meshari*” I, f. 50 v.

¹² N. Jokl, art. i cit. f. 147 v.

¹³ M. Roques, vep. cit., f. 13.

¹⁴ Shih J. Matzinger, “Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 2”, në: Bardhyl Demiraj (Hg.), *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992)* gewidmet, *Albanische Forschungen* 29, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2010, f. 451 v.

¹⁵ E. Çabej, “*Meshari*”, I, vep. cit. f. 53.

⟨ђѢ⟩ për afrikaten palatale *xh* [dZ], ku dy tingujt përbërës të saj *d-zh* në ciriliken kursive shënohen me ⟨гж⟩ ku *g* shënon [d]-në. Ky studiuës ka vënë re edhe ndonjë ndikim tjetër nga sllavishtja në grafisë e Buzukut, për të cilat nuk po zgjatemi këtu.

Në një studim të fundit, albanologu gjerman J. Matzinger ka vënë re edhe një ndikim tjetër të grafisë së Buzukut nga një model kroat i shkruar me shkronja latine, dhe pikërisht riprodhimin e afrikates palatale [tʃ] ç me ⟨c⟩ para një bashkëtingëlloreje ose me ⟨cc⟩ para një zanoreje, siç dëshmohet p.sh. në të parin tekst kroat me shkronja latine, të ashtuquajturin Leksionar të Bernardinit nga Spliti të vitit 1495¹⁶.

Për burimin deri sot të pashpjeguar të shënimit të gjatësisë së zanoreve nëpërmjet dyfishimit të grafemave zanore të Buzuku dhe në autorët e vjetër pas tij, i njëjti studiuës mendon për një ndikim nga shtypshkrimet e vjetra kroate me alfabet latin, në të cilat haset shpesh dyfishimi i grafemave për zanoret e gjata të kroatishtes¹⁷.

Ndikimet sllave në veprën e Buzukut janë të dukshme edhe në mënyrën e përkthimit të pjesëve të caktuara të tekstit të tij. Kjo lidhet ngushtë me çështjen ende të pazgjidhur të modeleve të teksteve fetare që ka pasur parasysh Buzuku në përkthimin e veprës së tij. Në këtë drejtim dha së pari një orientim të drejtë Mario Roques-u, i cili krahasoi librin e Buzukut me një libër orësh (horologium) të botuar në Venedik më 1512 nga Franjo Ratković prej Raguze. Ky është në fakt i pari libër i shtypur në ciriliken kroate, i quajtur edhe Breviari i Dubrovnikut. Roques-u vuri re përmbajtjen e njëjtë të këtij libri me atë të pjesës së parë të librit të Buzukut, që përmban elementet përbërëse të një breviari a libri orësh, si edhe pika të tjera të përbashkëta që e shtynë në përfundimin se Buzuku ka dashur t'u japë shqiptarëve një përmbledhje të ngjashme me librat që shihet të përdornin sllavët katolikë. Me fjalë të tjera, në bazë të rezultatit të këtij krahasimi del se shtysa apo frymëzimi për shkrimin e librit të parë shqip ka ardhur nga veriu sllavo-katolik. Problem për konfirmimin e këtij arsyetimi ka qenë mungesa e arritjes së botimeve të këtij lloji nga studiuësit brenda kufijve të Shqipërisë së mbyllur, mungesë që e ka ndier dhe shprehur Çabej në studimin e tij për Buzukun¹⁸. Ai arriti nëpërmjet arsyetimit logjik të shkrimit sllave jugore si model i drejtpërdrejtë i librit të Buzukut, pasi i bëri një shqyrtim krahasues tekstit të Buzukut me ato tekste që kishte në dispozicion dhe vuri re largime nga teksti latin e italian

¹⁶ J. Matzinger, art. i cit., f. 447.

¹⁷ J. Matzinger, art. i cit., f. 454 v.

¹⁸ E. Çabej, "Meshari", I, f. 27.

e përkime me tekstet greke, qoftë të Dhiatës së Vjetër qoftë të ungjillit bizantin. Ndikimet greke te Buzuku nuk mund të vinin veçse indirekt, nëpërmjet teksteve sllave, që edhe pse të ritit latin, vijonin traditën bizantine të sllavishtes së vjetër kishtare. Këtë mendim ai e gjeti të konfirmuar përsëri tërthorazi, në një recension të sllavistit M. Rešetar mbi botimin e një libri lutjesh kroatish të vitit rreth 1400 - *Hrvatski molitvenik* - të Raguzës, i cili është kopje e një modeli latin, por me gjurmë të qarta të praktikës sllavokishtare si në përkthim edhe në gjuhë. Në mungesë të një teksti të vjetër sllav parabuzukjan, Çabej i bëri krahasimet me Dhiatën e Vjetër e të Re të shekullit XIX të Daničićit e Karadžićit dhe, me gjithë largësinë prej disa shekujsh mes këtyre teksteve dhe atij të Buzukut, gjeti mjaft përkime të këtij të fundit me tekstin sllav (dhe grek)¹⁹.

Një fat më të mirë me literaturën burimore pati Martin Camaj, i cili ndodhej në Itali kur hartoi tezën e tij të doktoratës për “Mesharin” e Gjon Buzukut. Camaj vinte nga një qëndrim gjashtëvjeçar në Jugosllavi, ku kishte studiuar ndër të tjera sllavistikë në universitetin e Beogradit dhe kishte nisur atje studimet mbi Buzukun²⁰. Në punimin mbi “Mesharin” Camaj i kushtoi një vend të veçantë elementeve sllave të veprës së Buzukut. Ndikimet sllave në librin e Buzukut ai i vendos në rrethanat e simbiozës bregdetare adriatikase veneto-dalmate-shqiptare e cila, nën shtysën e faktorëve ekonomik-tregtarë, për shekuj të tërë ka përbërë një konstitution shpirtëror fetar e kulturor të njëjtë. Këto ishin ato zona të ndikimit venedikas deri në Raguzë që mbas pushtimit turk u quajtën “Albania veneta”²¹.

Natyrisht Camaj njihej me faktin se ndër kroatët që nga shek. XIII lulëzonte një letërsi kishtare në gjuhën popullore në tre shkrime të ndryshme: glagolitik, cirilik dhe latin²². Duke i kushtuar vëmendje literaturës historike që dokumenton kontaktet e klerit shqiptar me krahinat

¹⁹ Po ai, po aty, f. 34-38.

²⁰ Khs. punimin e tij “Prilog proučavanju grafije Gjon Buzukua” botuar në *Godišnjak* të Institutit Ballkanologjik të Sarajevos, nr. I, 1957.

²¹ M. Camaj, *Il “Messale”*, vep. cit., f. 66. Shih edhe M. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vëll. I, Città del Vaticano, 1992, dok. 218, f. 404, ku thuhet se “Dopo, che li Sig[nor]i Venetiani hanno perso l’Albania, danno titolo d’ Albania alla Dalmatia Superiore, cioè dalla Bocca di Cataro, ch’è città, e fortezza della Ser[enissi]ma Rep[ubli]ca Veneta posta alle radici di Monte Negro...”.

²² Khs. p.sh. Eduard Hercigonja, *Tropismena i trojezična kultura hrvatskoga srednjovjekovlja*, Matica hrvatska, Zagreb, 1994, (bot. 2 i zgjeruar 2006). Dragica Malić, *Na izvorima hrvatskoga jezika*, Matica hrvatska, Zagreb, 2002, f. 35-56.

kroate dhe dëshmime për qëndrimin e klerikëve shqiptarë në Raguzë në shek. XIV- XV, madje edhe për ndonjë prift shqiptar nga Shqipëria e Veriut që meshonte në sllavishten kishtare (*glagolaši*)²³, ai mendoi fillimisht për ndikime të letërsisë sllavokishtare “glagolitike” në tekstin e Buzukut. Për këtë bëri krahasimin e këtij me një meshar sllavokishtar të ritit latin të vitit 1531, pa mundur të gjejë ndonjë lidhje sintaksore apo ndikime leksikore, pas së cilës ai përjashtoi çdo varësi të përkthimit shqip nga tekstet glagolitike. Megjithatë, elementet sllave në tekstin e Buzukut flisnin për ndikime të kroatishtes popullore, që e shtynë studiuesin të kërkojë të dhëna për letërsi kishtare sllave në gjuhën popullore. Një letërsi e tillë kishte lindur që para shek. XIV përgjatë bregdetit dalmat, e përkthyer nga latinishtja, por me ndikime të drejtpërdrejta glagolitike. Përmbajtja e këtyre teksteve ishin pjesë ungjilli e leksionarë²⁴, psalme, ofice e himne, pra përmbledhje që përkonin më së miri me librin e Buzukut. Nga të dhënat historike e letrare për këta libra fetarë Camaj konkludoi se priftërinjtë shqiptarë që ishin marrë me përkthimin e teksteve fetare në gjuhën shqipe kanë qenë me siguri në kontakt me traditën letrare liturgjike në gjuhën popullore kroate, e në mënyrë të veçantë me leksionarët dalmatinas të shekujve XIV-XV të shkruar me alfabetin latin. Këto tekste, që ishin botuar me kohë nga filologë të shquar kroatë si Frano Radić, Milan Rešetar e Tomo Maretić, Camaj i bëri objekt krahasimi me tekstin e Buzukut. Ai që paraqiste përkimet më të shumta me këtë të fundit ishte i quajtur *Leksionar i Ranjinës*, i shkruar në vitin 1508 në Raguzë nga fisniku vendas Nikša Ranjina dhe i përshtatur në të folmen shtokavejekave të Dubrovnikut mbi bazën e leksionarit më të vjetër të françeskanit Bernardin Drvodilić nga Spliti, i shkruar në çakavishten-ikavase të bregderit verior kroat, i cili përmbante pjesë ungjilli të përkthyer nga tekste të mëparshme sllavo-kishtare. Këta leksionarë janë quajtur edhe *Evangeljari* dhe ky titull të kujton emërtimin “*L’Evangelij in albanese*” që përdor Pjetër Bogdani në një letër drejtuar Kongregacionit të Propagandës së Fesë në Romë në vitin 1655 ku përmend librat fetarë ekzistues në gjuhën shqipe, për të cilin Matteo Sciambra, që e pati zbuluar dokumentin mendonte se mund të jetë “Meshari” i Gjon Buzukut, mendim me të cilin pajtohen edhe Luigj Marlekaj e Dh. Shuteriqi²⁵. Ky i fundit pohon se në

²³ M. Camaj, *Il “Messale” di Gjon Buzuku*, Roma, 1960, f. 56 v, shënimet 7, 8, 9.

²⁴ Libra liturgjike që përmbajnë pjesët fetare nga Dhiata e Vjetër dhe e Re që lexohen në meshë.

²⁵ M. Sciambra, *Bogdanica. Studi su Pietro Bogdani e l’opera sua*, II, Bologna, 1965, f. 28. Shih edhe L. Marlekaj, *Pietro Bogdani e l’Albania del suo tempo*,

Veriun katolik veprat si “Meshari”, ku ungjijtë përbënin masën kryesore të lëndës, quheshin “Ungjillat”.

Përkimet me leksionarin e Ranjinës e shtynë Camajn të nxjerrë përfundimin se ky tekst ka qenë burimi i drejtpërdrejtë ose edhe i ndërmjetëm i ndikimeve sllave në “Mesharin” e Buzukut. Ky indikacion ka rëndësi të madhe në studimet buzukjane, pasi çel rrugën për krahasime sistematike me këtë tekst ose me versionet e ngjashme me të për të dokumentuar në mënyrë më të plotë burimin e drejtpërdrejtë të përkthimit (të pjesëve) të “Mesharit” të Buzukut, qoftë ky një tekst kroat apo një burim i përbashkët për të dy tekstet, shqip e kroatisht, ndoshta italian²⁶.

Të shohim disa nga rezultatet e kërkimit të Camajt për ndikimet e “Mesharit” nga tekstet sllave në pjesët e Ungjillit.

bdinj “ruaj; mri zgjuar”. Haset vetëm te Buzuku: *për të mitunë bdinjënë ata, që e ruonjënë* (11v11); *e bdini ndë oratë* (69r83 = 79r83); *itëni esëllë e bdini* (73v63 = 83v63); *me bdīm për ndëmateet m Tenëzonë* (83r7 = 103r7). Camaj 64 e sjell si një nga përkimet e Buzukut me leksionarët kroatë të fundit të shek. 15 e fillimit të shek. 16: *Bdini e uroni* (64r80) “vigilate et orate”/ *A sada bdite i molite* (Ungjilli i Bernardinit nga Spliti, 1495, f. 70), *Bdite i molite* (Ungjilli i N. Ranjinës nga Ragusa, 1508, § 153). Çabej e shpjegon nga serb. *bdeti, bdjeti*, e tashme *bdim*.

grom e. m. “bubullimë”. Fjalë e Buzukut: *E shumica qi aty isnë gjegjishnë e thoshinë: Gromi* (63r20) “Turba ergo, quae stabat, et audierat, dicebat tonitruum esse factum”. Camaj e vë në dukje si ndikim i Buzukut nga sllavishtja, duke e krahasuar me vendet përkatëse të leksionarit të Bernardinit nga Spliti (f. 69 *zgrmi*) dhe të Ranjinës nga Ragusa (§ 149 *zgrmi*), në të dy rastet si folje “bubullin”. Fjala shqipe është marrë nga serb.-kroat. *grom* “bubullimë”, siç e ka shpjeguar edhe Çabej (SE IV 292).

gjak e. m. “dhjak, gjakon”. Camaj e shënoi këtë fjalë të Buzukut si sllavizëm të drejtpërdrejtë të këtij shkrimtari, në shembullin: *e mbas andaj e një xhakon, gjak m ungjill, shkoi e si e pā bani kini nukë e sheh* (77r8 = 87r8) “similiter et levita, cum esset secus locum, et videret eum, pertransiit”. Teksti i Ranjinës § 267: *Takodje i dijak, kade dodje na mjesta, vidjev njega i mimoijde*. Bernardini i Splitit f. 131 ka *žakon*. Fjala del edhe

Liantonio Editrice, Palo del Colle (Bari), 1989, f. 68, shën. 66; Dh. Shuteriqi, *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2005, f. 108.

²⁶ Tekstet kishtarë sllave të kohës kanë qenë hartuar shpesh pas modeleve italiane, shih E. Çabej, “Meshari”, I, f. 37 me citim të M. Roques, “Deux livres d’heures du XVI^e siècle en cyrillique bosniaque”, *Revue des Etudes Slaves* XII 60, 69.

një herë tjetër te Buzuku: *O ju gjithë munëgj e remita, lutī për nē. O ju gjithë shenjtënë priftënë e gjak m ungjill, lutī për nē* (18v14-15). Camaj jep të dhëna nga Fjalori i Akademisë Jugosllave se forma *djak* ekziston te sllavët jugperëndimorë edhe në tekste të tjera të shek. XV. Sot *djak* në serbo-kroatisht = “nxënës”. Për “dhjak” përdoret *djakon*.

kërputunë f. kal. “arvoj”. Camaj vuri re i pari ekzistencën e kësaj fjale te Buzuku, në shembullin *tue kërputunë rjettë e tyne* (83r81 = 93r81) “reficientes retia sua” dhe e krahasoi me versionin përgjegjës kroat të leksionarit të Bernardinit nga Spliti (f. 41) *krpeći mriže svoje*.

pipni v. II shm. “prekni”. Folje që del vetëm te Buzuku: *këqyrni duortë e mī e kambëtë e mī, se u jam aj: pipni e shihni* (65r1 = 75r1) “palpate”. Siç e pa Camaj 62, është një huazim i drejtpërdrejtë i Buzukut nga modelet sllave: Leksionari i Bernardinit nga Spliti: *popipajte* (f. 105), Leksionari i N. Ranjinës *opipajte* (§ 207).

pod e. m. “dysHEME; kat i poshtëm; fund”. Camaj jep shembullin nga Buzuku: *e të bajnsh poda përposh* (60r71 = 70r71) “... et tristega facies in ea”, nga sll. *podъ* “dysHEME; kat”. Në ungjillin e Ranjinës nga Dubrovniku që sjell ai për krahasim del e njëjta fjalë: *pode i pribivališta prosječena učiniš u njoj*, e ndryshme me versionin latinisht kanonik të cituar (*tristega* “kati i tretë”). Te fjalja sllave mund të vihet re përdorimi i së tashmes së foljes me vlerën e së ardhmes (për lat. *facies*). Në shembullin tjetër nga Bernardini i Splitit folja madje është në lidhore *da učiniš*, që Camaj e shënon si paralelizëm identik me lidhoren karakteristike të Buzukut. Edhe në këtë drejtim të sintaksës së Buzukut vlen të ndërmerret një krahasim me tekstet kroate bashkëkohëse. Te Buzuku përdoret *pod* edhe në një rast tjetër për lat. *coenaculum* “kat i sipërm”: *e shpū mbë pod* (58r61) “portavit in coenaculum”²⁷. Për shembullin e dytë është i nevojshëm përsëri krahasimi me tekstet e vjetra kroate për të vërtetuar nëse ka përkime lidhur me përdorimin e fjalës *pod*.

riznicë e. f. “dhomë ku mbahet thesari, lat. *corbona*”. Te Buzuku: *këta z vijenjënë me u shtīm ndë riznicët* (55r19 = 65r19) “non licet eos mittere in carbonam”, *nukë pat shpënesë mbë riznicët të denarëvet* (83r27 = 103r27). Camaj 63 e vuri re si sllavizëm të këtij autori dhe e krahasoi me kroat.-serb. *riznica* me të njëjtin kuptim në shembullin e Ranjinës (§ 153) *nije dostojno postaviti njih u riznicu*, si huazim i drejtpërdrejtë nga sllavishtja.

starisfat e. m. “krushkaparë”. Fjalë e gegërishtes veriore. Gjendet në literaturën e vjetër që te Buzuku: *e u tha atëherë: merri tash, shpiri*

²⁷ Khs. G. Svane, *Slavische Lehnwörter im Albanischen*, Acta Jutlandica LXVIII, Aarhus University Press, 1992, f. 55.

starisfatit (38r59), *e mbassi starisfati e kërkoi, ujëtë ish bām venë* (38r61). Bogdani: *urdhënoj Jezu Krishti qi asosh të epej vena darsmorëvet, të sillënë posi e pa starisfati, se vena ish ma së mirët doreje* (II 49 18). E shpjegojnë sllavistët që nga Miklosichi, Meyeri e Selishevi si sllavizëm, nga serb. *stari svat* “dëshmitari i dytë në një martesë” (në thelb “dasmori më i vjetër”). Camaj 63 e krahason pasazhin e Buzukut nga dasma në Kanë të Galilesë me versionet gjegjëse kroate të 1495 e 1508-s në të cilat përdoret termi *stari svat*. Bern. f. 16: *I reče im Isus: zacrpite sada i ponesite starom svatu ... I kada okusi stari svat od vode vino učinjeno*. Ranj. § 52: *Reče njim Jesus: pocrpite sada, i dones'te staromu svatu. ... I kad okusi stari svat od vode vino učinjeno*.

shtrazë e. f. “roje”. Fjalë e geg. veriore. Përdoret nga të gjithë autorët e vjetër, edhe me rrjedhojën (derivatin) *shtrazëtar*. Buzuku: *e ata vonëte e vunë shtrazëtë vorrit* (55v89 =65v89) “munierunt sepulchrum cum custodibus”, *mbuluom gurë me shtrazët qi e ruonjinë* (55v90 =65v90), *e shtrazëtë ishnë përpara derësë qi por ruonjinë burgnë* (86v43 =96v43) “et custodes ante ostium custodiebant carcerem”. Këtë fjali të fundit Camaj 62 e sjell si shembull ndikimi nga tekstet kroate parabuzukjane të cilat përdorin fjalën *straža* “roje” në vendet përgjegjëse të Ungjillit: Bern. f. 153 *a strašci prid vrati čuvahu tamnice*, Ranj. § 338 *i straza prijed vrati čuvahu tamnice*. Është shpjeguar nga sllavistët, që nga Miklosichi, Meyeri e Selishevi, si sllave: serb. *straža* “roje; mbikëqyrje”.

tjesk e. m. “presë (për verë ose vaj)”. Fjalë e Buzukut: “*anshtë e kuqe dollama jote, e petëkatë e tū porsi aj që shtrydhën ndë tjeskut* (56v42 =66v42) “rubrum est indumentum tuum, et vestimenta tua sicut calcantium in torculari”, *e të trokullinjënë tjesqitë me musht e n voi* (71v8=81v8) “redundabunt torcularia vino et oleo”. Autorët e tjerë pas tij kanë, Bardhi: *tork*: torcular (174 24), Bogdani *vitell* “torchio”: *Përse është i kuq petëku yt posi i ndrydhuni ndë vitellt?* (II 139 2), *e kanë me u grumbulluem vitëjtë me venë e me voj* (I 137 3). E krahasoi së pari Camaj 64 me vendet përkatëse në tekstet e vjetra kroate duke vënë në dukje ngjashmërinë e veçantë me ungjillin e Nikola Ranjinës nga Raguza (1508): *i svite tvoje kako svite onijeh, koji treplju u tjesku?* (§ 158). Fjala e Buzukut përkon edhe nga forma me variantin jekav *tijesak* “presë, morsë” të të folmeve serbo-kroate perëndimore.

zakon e. m. “shprehi; doke; kanun”. Kjo fjalë, me përhapje në mbarë territorin e shqipes, shfaqet që në tekstet e vjetra shqipe të Veriut. Te Buzuku del edhe me kuptimin “ligj”, siç e vuri re së pari Camaj 1960, 65: *ky# kelq i rī zakon anshtë për gjakt tem* (57r71 (=67r71) “hic calix novum testamentum”, në tekstin e Bernardinit nga Spliti f. 123: *ovo je čaša*

novoga zakona. Rast tjetër me kuptimin “ligj” te Buzuku: *n nesh hjektë gjithë të pāligje n zakonit plak* (57r50 = 67r50) etj., kuptim i cili është afër burimit serbo-kroat *zakon* “ligj”. Buzuku e përdor edhe me kuptimin e sotëm “doke, shprehi”, që del te të gjithë autorët e tjerë pas tij si dhe në shqipen e përgjithshme.

Camaj sjell edhe një numër leksemash me prejardhje sllave të Buzukut që shfaqin tipare të gjuhës popullore, që sipas tij flasin për një ndikim të drejtpërdrejtë të letërsisë liturgjike kroate e në radhë të parë të “leksionarëve”. Disa nga këto fjalë janë:

beseditunë “bisedoj”. Sot në shqipe përdoret folja *bisedoj*, e rrjedhur prej emrit të huazuar nga sllavishtja *bisedë*. Nga tekstet e vjetra shqipe vetëm Buzuku përdor këtë trajtë të marrë drejtpërdrejt prej burimit sllav, serb. *besediti*: *e por uinjinë tue beseditunë ndër vetëhenë n kafshëshit, qi kishnë gjetunë Jezunë* (64r76 = 74r76) “et ipsi loquebantur ad invicem de his omnibus, quae acciderunt”. Camaj e sjell si një nga shembujt që paraqesin trajtën e gjuhës popullore serbo-kroate, çka tregon ndikimin e Buzukut nga letërsia liturgjike kroate e veçanërisht nga “leksionarët”.

shetat “shëtit”. Te Buzuku kjo fjalë del me këtë trajtë: *mbas mjesëdite hīn Suzana e shetatën ndërper perivolt të burit vet* (54r21), *e se ajo shetatën e u doq zemëra e tyne* (54r23), *e ish ende dimënë, e por shetatën Jezu ndë klishë* (59r62 = 61r62). Trajta *shetat-* e Buzukut është marrë drejtpërdrejt nga serbo-kroatishtja *šetati* (*se*), ndërsa *shetit* ka pësuar një shndërrim brenda shqipes²⁸. Camaj 61 e vë në dukje si fjalë sllave të Buzukut që shfaq trajta të gjuhës popullore.

tojagë e. f. “shkop, hu”. Fjalë e Buzukut: *merr tojagënë teme n dorë tande* (57v66) “tolle baculum meum in manu tua”, *e vu tojagënë përmbi faqe të djalët* (57v76), *erdh e me atë gjind e madhe me tojaga* (64v9) “venit et cum eo turba multa com gladis et fustibus”, *E tojaga luoj ndë dorë taj* (58r35 = 68r35). Camaj 61 e vuri në dukje si sllavizëm të Buzukut, nga serb. *tojaga*. Burimi i parë i fjalës ka gjasë të jetë protobullgarishtja turko-tatare, meqë fjala i përgjigjet turq. *dayak* “e rrahur; mbështetje”, më parë edhe “shkop”²⁹.

Camaj shënon edhe disa terma të tjerë të Buzukut që ai i quan me prejardhje boshnjake, siç është *opqinë* “familje e madhe, fis” nga serbo-kroat. *općina* “komunë”; serb. *opština* është një bullgarizëm. Pastaj folja *glumitenë* “luajnë, bëjnë shaka” nga serb. *gluma* “shaka, lojë”, *goveda* emër kolektiv “gjedh” nga serbo-kroat. *govedo* shm. *goveda*; *sojnicë*

²⁸ G. Svane, vep. cit., f. 255.

²⁹ G. Svane, vep. cit., f. 80.

“hambar drithi” që Camaj e lexon me [s-] dhe e lidh me serbo-kroat. *sojenica* që jep Fjalori i Ak. Jug., ndryshe nga Çabej që e lexon [shojnicë] dhe e lidh në analizë të fundit me gjerm. *Scheune*.

Fjalët me burim sllav që gjenden vetëm te Buzuku mund të konsiderohen nga njëra anë si ndikime të modeleve letrare sllave në gjuhën popullore që do të ketë pasur ai në duar, por nga ana tjetër, mund të jenë edhe ndikime të këtij autori nga të folmet sllave në kontakt në një zonë gjuhësore të përzier, në veri të truallit gjuhësor të shqipes kompakte, ku mendohet se ndodhet vendlindja e Buzukut. Për një përcaktim më të saktë të njërit apo tjetrit pohim do të duheshin kërkime më të thelluara në literaturën e vjetër kroate me shkrim latin ose cirilik bashkëkohëse me Buzukun. Në tekstet kroate të marra në shqyrtim nga Camaj këto leksema nuk kanë korresponduesit sllavisht, p.sh. për *sojnicë/shojnicë* përdorin *granar*, nga lat. *granarium*.

Gjithsesi edhe Camaj thekson se tekstet sllave i kanë shërbyer Buzukut më tepër si objekt konsultimi në punën e vështirë të përkthimit, ndërkohë që burimi parësor ka qenë me siguri ai latin³⁰.

Puna e bërë nga Camaj dhe rruga që çeli ai me indikacionet për monumentet kroate bashkëkohëse me Buzukun si modele të mundshme për librin e tij pati pasoja largvajtëse që arritën rezultate kohët e fundit, kur po vihet re një rigjallërim i studimeve buzukjane e të shqipes së vjetër në përgjithësi. Krahاسimet me këto tekste mund të shërbejnë për të shpjeguar çështje të vështira ende të pazgjidhura të gjuhës së Buzukut. Një nga këto pikëpyetje që ka shkaktuar diskutime ndër studiuesit është çështja e së ardhmes me *do* te Buzuku, e mbështetur në një shembull të vetëm, që është menduar si dëshmi e ekzistencës së këtij tipi të së ardhmes edhe në gegërishte, në një fazë më të vjetër të shqipes. Studiuesi J. Matzinger i ka kushtuar vëmendje së fundi kësaj dukurie sintaksore të Buzukut, dhe, nëpërmjet krahasimit me leksionarët kroatë të shek. XV, e sidomos të Mesharëve Romanë para Koncilit të Trentit, ka vënë në dyshim si të pambështetur në fakte ekzistencën e këtij tipi të së ardhmes te Buzuku³¹. Shembulli i Buzukut: *A nukë do të pī kelqinë që më ordhënoi ati*, në dritën

³⁰ M. Camaj, “*Il Messale*”, f. 66.

³¹ J. Matzinger, “Die albanische Sprache...”, art. i cit., f. 456-460, me citimin e burimeve dhe të literaturës përkatëse. Më parë edhe në J. Matzinger, “Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 1: Ein Überblick zur vorliterarischen Dokumentation”, në Monica Genesin & Joachim Matzinger & Giancarlo Vallone (Hgg.), *The living Skanderbeg. The Albanian Hero between Myth and History*, Hamburg, Verlag Dr. Kovač, f. 53v.

e të dhënave të teksteve të shqyrtuara, interpretohet si fjali pyetëse retorike me foljen e zgjedhueshme kuptimplotë *dua* në vetën III njëjës: “A nuk do (ti) që unë të pi kupën...?”. Ky ndërtim haset në të gjithë leksionarët e mesharët kroatë të kohës para Buzukut që autori ka shqyrtuar me këtë rast, dhe përkon veçanërisht me leksionarin e Bernardinit nga Spliti (f. 48, 19): *Čašu ovu ku mi je dal otac nećeš li da ju popiu* “Këtë kupë që më dha ati, a nuk do që ta pi”. Tekstet kroate në këtë pikë nuk përkojnë me versionin kanonik të sllavishtes së vjetër kishtarë (*ne imamъ li piti eję*), i cili mbështetet në versionin primar grek $\theta \in B \cong \theta Z \Delta 4 \cong <^{\text{TM}} * \Xi * T 6, < : \cong 4 \textcircled{R}$ $B \forall \theta Z \Delta \cong \Leftrightarrow : \leftarrow B : . T \forall \Leftrightarrow \theta$ “të mos e pi?”, po ashtu si teksti biblik latin i detyrueshëm pas Koncilit të Trentit, i quajtur Vulgata Clementina e vitit 1592, i cili e jep ndërtimin grek me futurin latin *non bibam illum*, version që gjuhëtarët e kanë përdorur për krahasim me fjalinë e Buzukut. Përkundrazi, si tekstet e vjetra kroate, ashtu dhe libri i Buzukut përkojnë me versionin latin të Mesharit Roman para Koncilit të Trentit, i cili pjesën e ungjillit të Gjonit 18, 11 e formulon kështu: *Calicem quem dedit mihi pater, non vis ut bibam illum?* “nuk do që unë ta pi?”. Kontekstet e tjera të ngjashme me këtë nga Buzuku nuk konfirmojnë të ardhmen me *do*: p.sh. 048r24 «a munde pini iu chelhine: hi u cã meh piiteh?» *a mundë pini ju kelqinë qi u kam me pītē?*³².

Me këtë riinterpretim të fjalisë së diskutuar të Buzukut del edhe një herë në pah rëndësia e marrjes në konsideratë për krahasim të teksteve fetare bashkëkohore me Buzukun, d.m.th. paratridentine, për të shmangur interpretimet e pasakta që vijnë nga krahasimet me versionet më të reja e të ripunuara, drejtim në të cilin Camaj qe udhërrëfyes.

³² Khs. edhe S. Mansaku, “Sur la typologie et la chronologie des formes du futur en albanais”, në *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*, Albanische Forschungen 29, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2010, f. 335v.